



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351-160288

Dt. 05.10.2016

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesën e **Ibrahim Banovci** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Jusuf Gërvalla”** në bazë të neneve 3-1.7. , 1.17. dhe nenit 5.1.1 si dhe nenit 14.1.1 si dhe në lidhje me nenin 15 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82. e në lidhje me nenin 84. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

## AKTVENDIM

**I. I LEJOHET: Ibrahim Banovci** që të bëj mbindërtimin e objektit - **Shtëpi individuale** në Prizren në vendin e ashtuquajtur **“ / “** rrugën **“ Jusuf Gërvalla” nr. 40** në ngastrën kadastrale e cila është e identifikuar në Aktin mbi kushtet për rregullimin e hapësirës nr. **04-353-107228** si dhe me Aktvendimin mbi lokacionin e objektit, sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e **byrosë projektuese N.SH.T. “PROJECHT-ING”**.

**II.** Dokumentacioni Teknik e mbanë titullin e tipit **veçantë**.

**III.** Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **21.054,48 €**.

**IV.** Ndërtimi i objekteve ndihmëse s’është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga parallogaria e vlerës së objektit.

**V.** Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspekcionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.

**VI.** Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtrojë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.

**VII.** Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjet) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.

**VIII.** Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve urbanistike si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori, të njëjtit të vërtetuar në aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës

**IX.** Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit).

**X.** Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rretit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDS-it, dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

.../...

## Arsyetim

**Parashtruesi i kërkesës: Ibrahim Banovci nga Prizreni me banim në rrugën “Jusuf Gërvalla” nr. 40 i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për mbindërtim të objektit - Shtëpi individuale.**

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, aktvendimin mbi bartjen e pronësisë, me të cilat i ka zgjidhur marrëdhëniet pronësoro – juridike, Kushtet ndertimore, Aktvendimin mbi lokacionin, dëftesë pagesat që i ka paguar kontributet për rregullimin e tokës ndërtimore, si dhe projektet.


Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtimin e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënie të lejes së ndërtimit.

Nga se u tha më lartë u muarr aktvendimi si në dispozitiv.

**KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE;** Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Bashkëpunëtorët profesional:



*Xhejlane Gjini, inxh.dipl.ark.*

DREJTORI



*Visar Islamaj*